

**Fjalimi i Zonjës NDI Madeleine K. Albright  
para deputetëve të Kuvendit të Kosovës  
5 korrik 2005**

Ju faleminderit shumë. I jam mirënjohëse Presidentit Rugova dhe Kryeministrit Kosumi, Kryetarit Daci dhe Kryesisë së Kuvendit për mikpritjen e tyre dhe për nderin që më bënë duke qenë personi i parë i ftuar në një seancë të posaçme të këtij institucioni demokratik.

Unë vlerësoj shumë mikpritjen tuaj. Më keni bërë të ndihem si në shtëpinë time dhe më keni dhënë mundësi që të repërtijë shoqërimin me disa miq shumë të dashur.

Gjithashtu, dëshiroj që të përshëndes disa mysafirë, përfshirë këtu Phil Goldberg, shefin e misionit të SHBA-ve, dhe zëvendësin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Larry Rossin. Prania e tyre sot dhe puna e tyre e madhe që ata e bëjnë çdo ditë reflekton interesin e vazhdueshëm të botës për mirëqenien dhe ardhmërinë e Kosovës.

Siç e dini, ndodhem këtu gjatë kësaj fundjave në cilësi të vizitës private, si Kryesuese e organizatës amerikane Instituti Demokratik Kombëtar (NDI). Tashmë nuk flas në emër të qeverisë amerikane. Por kurrë nuk do ta harroj vizitën time këtu, gjashtë vjet më parë, si Sekretare e Shtetit.

Kam folur para një turme të madhe në sheshin e këtij kryeqyteti. Kudo ka pasur parulla dhe flamuj. Ishte një kohë me ndjenja të shumta, të pikëllimit dhe kënaqësisë, të mllëfit dhe shpresës. Vitet e shtypjes së rëndë dhe tmerrit të pastrimit etnik kishin marrë fund. Lufta kishte mbaruar. Refugjatët po ktheheshin. Të zhvendosurit po u ktheheshin shtëpive të tyre. Më në fund, Kosova ishte e lirë.

Së bashku ne u betuam se në Kosovë kurrë më nuk do të vinin natën njerëzit me pushkë; kurrë më nuk do të digjeshin shtëpi dhe fshatra, kurrë më nuk do të kishte terror dhe varreza masive. Kurrë më nuk do të ketë njerëz në Kosovë që jetojnë në frikë.

Kishte ardhur koha që të fillohej një epokë e re, në këtë vend të njohur, si pjesë e një fillimi të ri për tërë regjionin.

Shumëçka ka ndryshuar që nga ajo ditë korriku gjashtë vjetësh më parë. Kur kam folur atëherë kam qenë e rrethuar nga ushtarët dhe e mbrojtur në një makinë të blinduar. Mbrëmë, kam folur në një koncert ku rrethohesha nga njerëz të rinj, të cilët dukeshin njësoj si edhe evropianët tjerë, me sytë e tyre plotë jetë, dhe zemrat e tyre plotë shpresë. Sot po flas para këtij institucioni të lindur rishtazi por edhe shumë mbresëlënës – një dëshmi e prekshme e përkushtimit të Kosovës për liri.

Gjatë këtyre gjashtë viteve të shkuara, ju i keni treguar botës së njerëzit e Kosovës janë ndërtimtarë të vërtetë, jo vetëm ndërtimtarë të njohur në botë për ndërtimin e shtëpive dhe ndërtesave publike, por ndërtues të institucioneve të reja. Burrat dhe gratë e secilës moshë dhe etni kanë punuar që të vënë themelet e demokracisë. Ju keni formuar partitë politike dhe keni

mbajt zgjedhjet. Ju keni zhvilluar mediat e pavarura dhe keni vendosur sistemin e drejtësisë. Ju keni formuar qeveritë në nivelin qendror dhe lokal dhe keni punuar në mënyrë konstruktive me bashkësinë ndërkombëtare. Dhe kështu i jeni afruar ditës së shumëpritur kur statusi final do të përcaktohet. Ju uroj për të arriturat e juaja.

Lëvdatat për këto të arritura u takojnë të gjithë njerëzve të Kosovës, shqiptarëve, serbëve, boshnjakëve, turqve, romëve, egjiptianëve, ashkalive, goranëve e të tjerëve, të cilët kanë ndihmuar që të ndërtohet një shoqëri më e mirë. Keni shumë arsye për të qenë krenar. Të arriturat e juaja i bëjnë krenar edhe miqtë e juaj. Unë e di këtë sepse unë jam një prej tyre, dhe do të jem gjithmonë. Kur ju bëni një hap përpara, unë gëzohem shumë.

Ju më njihni si një mike tuajën, por ju po ashtu më e dini që jam e sinqertë. Si një mike, ndiej përgjegjësi që të ju them se çfarë mendoj për detyrat të cilat mbeten të papërbushura dhe t'ju paralajmëroj për sfidat përpara jush. Së pari, ju përballeni me sfidën e krijimit të një ekonomie të shëndoshë e cila gjeneron vende pune dhe u jep njerëzve besimin se do të jenë në gjendje të ndërtojnë ardhmërinë e tyre në tokën e stërgjyshërve.

Kosova e ka popullatën më të re, por gjithashtu edhe shkallën më të madhe të papunësisë në Evropë. Nuk mundem e të mos pyes veten për të rinjtë që i pashë mbrëmë. A thua çfarë bëjnë ata sot? A e kanë ata arsimin që u duhet për t'u bërë të aftë të mbajnë familjet e tyre si dhe të konkurrojnë me ekonomitë tjera të botës? A do të kenë ata mundësitë që i meritojnë për të shfrytëzuar plotësisht energjinë dhe shkathësitë e tyre?

Unë pyetem sidomos për vajzat e reja në turmën e mbrëmshme. A do tu jepet atyre mundësi e barabartë për të shkëlqyer në klasë, për të arritur sukses në vendin e punës, si dhe për t'i ndjekur ëndrrat e tyre në cilëndo fushë që ato kanë dëshirë – të bëhen biznesmene apo mjeke, gazetare apo programere kompjuterësh, a po bile edhe kryetare apo kryeministre të ardhshme? Të gjithë e dimë se sukcesi në shoqëri nuk është i mundur nëse gjysma e popullsisë është e lënë pas dore. Jam e inkurajuar që shoh se jo vetëm që ka shumë femra në këtë Kuvend, por që gjithashtu vërej se femrat po fillojnë që të marrin edhe pozitave udhëheqëse në kuadër të partive të tyre, edhe pse më pak në kuadër të udhëheqjes së këtij Kuvendi, në qeveri apo nëpër komuna. Po pres me padurim që të ju shoh të gjithave në takimin e mëvonshëm të grave parlamentare.

Kosova përballlet edhe me një sfidë të dytë, dhe ajo është ndërtimi i një shoqërie të qeverisur nga sundimi i ligjit. Nuk është fshehtësi se korrupsioni dhe krimi paraqesin një problem këtu, ashtu si edhe në shumë vende tjera të botës. Jemi të prirur që të mohojmë këtë sepse nuk ka shoqëri e cila dëshiron të jetë në zë për korrupsion. Por problemi nuk mund të adresohet përveç nëse haptazi e pranojmë dhe i kundërvihemi atij. Dhe ai nuk mund të zgjidhet përveç nëse policia dhe autoritetet gjyqësore janë të pavaruara dhe të paanshme, jashtë çdo dyshimi, dhe të përkushtuara që të hetojnë detalisht krimet pa marrë parasysh gradën apo pozitën e të akuzuarve, pa marrë parasysh nëse ata janë njerëz në pushtet apo opozitë. Sundimi i ligjit vjen kur publiku e kërkon atë me ngulm. Populli i Kosovës meriton jo më pak se kaq.

Sfida juaj e tretë është më themeloria. Ajo është që të ndërtoni një shoqëri të bashkuar, në të cilën secili grup etnik mund të marrë pjesë dhe kontribuoj. Kur isha këtu gjashtë vjet më parë kam thënë se ka njerëz të cilët dëshironin që Kosova të dështoj. Këta cinikë parashikonin se

popullata shumicë në Kosovë do t'ua bëjë të pamundur jetën normale të tjerëve. Ata ishin të sigurt se Kosova e re do të jetë vend pa tolerancë dhe i dhunshëm dhe se minoritetet do të ishin të diskriminuara dhe se nuk do të ndjeheshin të mirëseardhur. Në atë kohë unë parashikoja se ju do t'i dëshmoni këto kritika si të gabueshme. Përkundër ngjarjeve të turpshme të Marsit 2004 dhe këmbëngulësisë së ekstremistëve për të ngjallur urrejtje, unë ende besoj se ju do t'i dëshmoni botës se këto kritika nuk qëndrojnë. Mirëpo, këtë nuk mund ta bëni vetëm duke deklaruar se serbët mund të jetojnë në Kosovë. Ju duhet të jeni të gjendje të thoni se të gjithë – duke përfshirë shqiptarët, romët, ashkalinjtë, goranët, boshnjakët dhe turqit – mund të jetojnë, kudo në Kosovë, të sigurt dhe në paqe.

Gjatë fluturimit tim mbi Kosovë pashë xhamia të rindërtuara, por gjithashtu pashë edhe kisha serbe të dëmtuara dhe të rrethuara me tela gjemborë. Ju duhet të jeni në gjendje të thoni se trashëgimia kulturore dhe objektet historike të kultit, të shenjta për një komunitet etnik në Kosovë, nderohen dhe respektohen nga të gjitha komunitetet tjera. Kjo do të jetë dita kur ju vërtetë do të dëshmoni se kritikët tuaj kishin gabuar. Kjo do të jetë dita kur do të jetë e plotë fitorja mbi Sllobodan Millosheviqin dhe ato për të cilat ai luftoi. Kjo do të jetë dita kur ju do t'i tregoni botës se qytetarët e Kosovës janë të sigurt dhe me besim, të fokusuar qartë në të ardhmen e tyre dhe të liruar nga shpirtrat dhe barra e së kaluarës. Ky do të jetë hap gjigant drejt krijimit të demokracisë së vërtetë dhe të qëndrueshme këtu në Kosovë.

Ky është testi juaj i fundit, për ndërtimin e demokracisë funksionale. Siç keni pasur rast të mësoni në vitet e fundit, demokracia është test për të gjithë. Ajo kërkon që të gjithë të kontribuojnë në suksesin e shoqërisë. Mirëpo ju, si liderë politikë, keni obligim të veçantë për të pyetur veten: Cila është detyra ime për Kosovën? Çfarë mund të bëjë unë për të ndihmuar ndërtimin e Kosovës demokratike dhe prosperuese?

Përgjigja ime do të ishte se ju mund të punoni për të zhvilluar kulturë politike që u mundëson të gjithëve pjesëmarrje në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, gjinore apo fetare. Dhe ju mund të udhëhiqni duke u qenë vet shembull. Kjo kërkon më shumë se sa ecje bashkë me masën, nganjëherë duhet të ngriheni kundër masës, sepse edhe në demokraci, masa mund të gabojë, posaçërisht kur frymëzohet nga pasionet e jo nga arsyeja. Lideri i vërtetë duhet të bëjë shumë më shumë se sa të reflektojë opinionin publik; ai ose ajo duhet të punojë për të formësuar këtë opinionin publik drejt fuqizimit dhe zgjerimit të demokracisë. Puna e Kuvendit të Kosovës do të luajë rol vital në këtë drejtim dhe në formësimin e ardhmërisë së Kosovës. Kjo është skena nga e cila drama e demokracisë kosovare do të paraqitet. Dhe ju, anëtarët e saj, do të luani rolin kryesor gjatë debateve, diskutimeve madje edhe gjatë polemikave plot pasion rreth veprimeve specifike dhe politikave të cilat duhet t'i ndërmarr qeveria juaj dhe në fund të arrini kompromis. Sepse kur veproni, nuk e bëni këtë thjesht për vetveten apo interesat e partisë tuaj; ju veproni për të gjithë ata që i përfaqësoni dhe për interesat e Kosovës.

Anëtarëve të Kuvendit u është dhënë besim i madh. Ju keni rastin të bëni këtë Kuvend model të llojit të vet: efektiv dhe të përgjegjshëm, demokratik dhe korrekt. Për të arritur këtë, ju duhet të pajtoheni se çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të jetë ky Kuvend. Nëse më pyesni mua, do t'ju thoja se ky Kuvend duhet të jetë vendi ku të gjitha segmentet e popullatës së Kosoves janë të përfaqësuar dhe janë në gjendje të punojnë së bashku por të mirën e përbashkët. Kjo do të thotë

se të gjithë përfaqësuesit e zgjedhur duhet të zënë ulëset e tyre dhe të mirëpritën. Kjo do të thotë se Kuvendi duhet të jetë vendi ku shumica i përmbush obligimet e veta rreth udhëheqjes duke krijuar rregulla të cilat mundësojnë që do të dëgjohen zëra kundërshtues qoftë në komisione parlamentare qoftë në seanca plenare. Duhet të jetë vendi ku politikat zyrtare mund të mbrohen dhe kritikohen në një atmosferë pa frikësime dhe kërcënime. Duhet të jetë vend i lidhur me dhe i përkushtuar që t'u shërbejë qytetarëve; vend ku mbahen dëgjime publike dhe ku anëtarët e saj takohen rregullisht me qytetarët. Duhet të jetë vend i hapur për qytetarë, ku kosovari i thjeshtë mund të shoh dhe vlerësoj punën e këtij institucioni dhe anëtarëve të tij. Duhet të jetë institucion profesional, ku legjislacioni shqyrtohet me kujdes dhe implementimi i ligjeve monitorohet për së afërmi për të siguruar përmbushje të nevojave publike.

Përgjegjësitë e koalicionit qeverisës janë të shumta. Por edhe ata që janë në opozitë kanë përgjegjësitë e tyre. Si anëtare e Partisë Demokratike të Shteteve të Bashkuara, më besoni se e di si është të jesh në opozitë. Kam kaluar më shumë kohë jashtë qeverisë se sa brenda saj. E urrej humbjen, por gjithashtu kam mësuar se kohërat ndryshojnë e me këtë edhe mendjet e votuesve. Në skenë dalin liderët e rinj. Dhe disa prej jush që sot jeni në opozitë, një ditë do të gjendeni në krye të qeverisë. Kjo është arsyeja përse opozita ka përgjegjësi jo vetëm të kritikoj, por edhe të paraqes idetë e veta. Kjo është arsyeja përse të dy palët, si shumica ashtu edhe opozita kanë interes në respektimin e të drejtave të tjerëve.

Në fund, më lejoni t'ju them se jam e vetëdijshme, sikurse edhe tërë komuniteti ndërkombëtar, se qytetarët e Kosovës kanë trashëguar një sfidë të madhe në vitin 1999. Ju keni bërë përparim të shquar drejt plotësimit të ëndrrës suaj. Dhe për shkak të përpjekjeve tuaja të mëdha, ju nuk keni qenë vetëm në përballimin tuaj me problemet. Ju keni pasur përkrahjen e Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shume organizatave jo-qeveritare.

Jam krenare që Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) ka punuar me shumë prej jush në fuqizimin e partive politike, përkrahjen e këtij Kuvendi dhe në ndërtimin e shoqërisë civile. Dhe mund t'ju siguroj se ne do të vazhdojmë t'ju ndihmojmë në çdo mënyrë që mundemi.

Ne kemi interes të posaçëm në gjeneratën e re të liderëve, të rinj dhe të reja të cilët do të bartin mbi vete detyrat e nisura më herët, fëmijët e të cilëve do të fillojnë jetën e tyre në liri, në shekullin e ri me një ardhmëri me shpresa dhe premtime pa kufij.

Para gjashtë vjetësh ju fituat lirinë tuaj. Që prej atëherë, e keni përdorur mjaft mirë këtë liri. Në vitet në vazhdim, do të testoheni vazhdimisht nga kërkesat e demokracisë.

Në muajt e ardhshëm, komuniteti ndërkombëtar do të vështrojë për së afërmi progresin e juaj në ndërtimin e qeverisë në shërbim të qytetarëve, në përkushtimin e juaj për demokraci dhe në sukseset tuaja në krijimin Kosovës së hapur dhe të sigurt për të gjithë. Këto janë standarde të larta dhe vëzhgimi me të cilin do të përballemi do të jetë kritik dhe aspak i këndshëm. Por ju nuk duhet të harroni rrugën e gjatë që keni kaluar dhe drejtimin në të cilin Kosova demokratike duhet të shkojë. Ardhmëria juaj varet nga ju, ashtu siç edhe duhet të jetë.

Miqtë tuaj besojnë se ju do të jeni të suksesshëm dhe do të shohim këtu, në Kosovë, formimin e një shoqërie i cili respekton të drejtat e të gjithëve dhe i cili ka fituar respektin e popujve dhe qeverive në çdo skutë të botës.

Ju falënderoj edhe një herë për mikpritjen dhe vëmendjen tuaj.

Dhashtë zoti që Kosova të prosperojë dhe të jetojë përgjithmonë në liri dhe paqe.